



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|   |            |          |                 |
|---|------------|----------|-----------------|
| Pranimi / Dërgimi<br>Prilazimi / Prilazje<br>Recepcioni / Recepcija | 02.02.2024 | 4        | Vendi<br>Lokali |
| Organ / Shkalla<br>Organ / Shkalla<br>Drejtori / Drejtorja          | 8EDMSTHCK  | 684/2024 | 1112            |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1482/23**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1482/2023, të datës 06.12.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në çështjen juridike „ndërpërprje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2024, mori këtë:**

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1482/2023, e datës 06.12.2023, e parashtruar nga ankuesi**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.667/XI/2023, i datës 06.11.2023, i Komisionit Disiplinor në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale-Ministria e Shëndetësisë.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi më datë 06.12.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1482/2023, kundër Vendimit me Nr.667/XI/2023 të datës 06.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (*tutje referuar vetëm AKPPM*), për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli*) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.12.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për



Produkte dhe Pajisje Medcionale, ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.12.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokolli 404/2024, të datës 22.01.2024, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1482/2023, të datës 06.12.2023.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 06.12.2023 me numër protokolli 7250/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.667/XI/2023 të datës 06.11.2023 të Komisionit Disiplinor; Inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 10.10.2023; Komunikimin elektronik të datës 06.11.2023 ndërmjet ankuesit, zv.kryeshefit ekzekutiv dhe nëpunësve gjegjës të AKPPM-së; Raportin e datës 13.11.2023 të ankuesit lidhur me ndërprerjen e përkohshme të punës nga QMF 11-Prishtinë; Raportin e datës 03.11.2023 të ankuesit lidhur me ndërprerjen e përkohshme të punës nga QMF 11-Prishtinë; Raportin mjekësor të datës 06.11.2023 drejtuar ankuesit nga Klinika e Neurologjisë-QKUK; Komunikimin elektronik të datës 27.09.2023, 06.10.2023, 09.10.2023, 10.10.2023, 05.10.2023, 16.10.2023, 13.10.2023, 03.10.2023; 02.10.2023, 29.09.2023 ndërmjet ankuesit, zv.kryeshefit ekzekutiv dhe nëpunësve gjegjës të AKPPM-së; Vendimin me Nr.572/IX/2023 të datës 28.09.2023 të zv.Kryeshefit ekzekutiv të AKPPM-së; Raportin final të auditimit të brendshëm me Nr.Prot.05-5867 të datës 21.09.2023 të MSH-së; Vendimin me Nr.591/X/2023 të datës 06.10.2023 nga zv.Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.12.2023 nga KPMSHCK-ja; Përgjigjen në ankesë të datës nga AKPPM-ja së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë: Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit me Nr.Prot.1271 të datës 01.08.2012 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 01.04.2016; Vendimin me Nr.628/X/2023 të datës 11.10.2023 të zv.Kryeshefit Ekzekutive lidhur me emërimin e Komisionit Disiplinor; Ftesën e datës 27.10.2023, 30.10.2023 përmes e-mailit zyrtar nga zyrtarja e personelit për zv.kryeshefin ekzekutiv dhe ankuesin lidhur me pjesëmarrjen në seancë disiplinore; Procesverbalin e datës 31.10.2023 të Komisionit Disiplinor të AKPPM-së; Vendimin me Nr.668/XI/2023 të datës 08.11.2023 të Komisionit Disiplinor të AKPPM-së; vendimi nr.46/II/2023 I DATES 02.02.2023, Komunikimet elektronike të datës 31.10.2023, 27.10.2023, 06.10.2023, 09.10.2023, 13.10.2023, 05.10.2023, 16.10.2023, 29.10.2023, 02.10.2023, 03.10.2023, 27.09.2023 ndërmjet ankuesit, zv.kryeshefit ekzekutiv dhe nëpunësve gjegjës të AKPPM-së; Kërkesën me Nr.Prot.3369 të datës 21.09.2023 nga Vendimin me Nr.572/IX/2023 të datës 28.09.2023 nga zv.Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së; Komunikimet elektronike të datës 09.10.2023, 02.10.2023, 30.08.2023, 29.08.2023, 18.08.2023, 20.12.2023, 01.12.2023 ndërmjet ankuesit, zv.kryeshefit ekzekutiv dhe nëpunësve gjegjës të AKPPM-së; Kërkesën me Nr.Prot.4107 të datës 20.11.2023 lidhur me qasjen ne dokumente publike dhe informacion nga Avonet; Kërkesën me Nr.Prot.4203 të datës 27.11.2023 lidhur me qasjen në dokumente publike dhe informacion nga avonet; Vendimin me Nr.716/XI/2023 të datës 27.11.2023 të zv. Kryeshefit Ekzekutiv të AKPPM-së; Vendimin me Nr.717/XI/2023 të datës 29.11.2023 të zv.Kryeshefit Ekzekutiv të AKPPM-së; Komunikimet elektronike të datës 26.09.2023, 22.09.2023, 17.08.2023, 08.09.2023 të zv. Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme drejtuar nëpunësve të AKPPM-së; Gjendjen aktuale të hyrjedaljeve për ankuesin të datës 24.04.2023, 14.03.2023, 14.03.2023, 21.06.2023, 28.02.2023,



09.02.2023, 13.02.2023, 12.01.2023, 01.09.2023, 07.09.2023, 02.08.2023, 01.06.2023, 02.06.2023, 13.06.2023, 02.05.2023, 05.04.2023, 14.04.2023, 02.03.2023, 09.03.2023, 14.03.2023, 22.09.2023, 22.09.2023, 03.07.2023, 10.07.2023, 14.07.2023, 02.10.2023, 05.10.2023, 06.10.2023, 15.02.2023, 16.05.2023, 16.06.2023, 17.10.2023, 19.07.2023, 20.02.2023, 20.03.2023, 21.06.2023, 21.09.2023, 22.06.2023, 24.04.2023, 24.10.2023, 25.07.2023, 27.01.2023, 27.03.2023, 27.06.2023, 22.08.2023, 28.04.2023, 28.07.2023, 28.09.2023, 30.06.2023, 30.10.2023, 31.01.2023, 31.05.2023; Raportin e auditimit me Nr.05-5867 të datës 21.09.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë; Komunikimet elektronike të datës 01.12.2023, 26.09.2023, 22.09.2023, 07.09.2023, 20.10.2022, 30.05.2023, 17.07.2023, 08.09.2023, 22.07.2023, 17.08.2023, 06.02.2023, 04.08.2023, 06.02.2023, 06.02.2023, 26.09.2022, 30.06.2022, 01.03.2022, 30.05.2023, 04.08.2023, 26.09.2022, 01.03.2022, 17.08.2023, 04.08.2023, 26.09.2022, 30.06.2022, 01.03.2022, 26.09.2022, 30.06.2022, 20.10.2022, 07.11.2022, 20.10.2022, 29.09.2022, 11.10.2019, 16.09.2019, , 14.06.2019, 21.03.2019, 15.02.2019, 12.02.2019 ndërmjet nëpunësve të AKPPM-së; Listën me produkte për të cilat nuk është kërkuar autorizim marketingu; Listën e SSHKUK-së për 32 produktet orfane; Komunikimin elektronik të datës 30.12.2022, 30.08.2023 ndërmjet nëpunësve të AKPPM-së lidhur me autorizim marketingun; Vendimin me numër protokolli 404/2024 të datës 22.01.2024 të Këshillit lidhur me vazhdimin e aftit të ankesës së ankuesit si dhe Procesverbalin e seancës dëgjimore të mbajtur me datë 26.01.2024 në rastin e ankuesit në Këshill.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe se i njëjti sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt emërimit me Nr.Prot.1271 të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës së Drejtorit të Departamentit të Autorizim Marketingut (tutje DAM).

Me tej, nga provat materiale të kësaj çështje rezultojnë se Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-se, me datë 10.10.2023, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mos kryerjes së detyrave të punës të dhëna nga mbikëqyrësi, mos zbatimin e duhur të tyre si dhe neglizhencës së vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës, me arsyetimin se:

- *Nga data 06.10.2023 ka kërkuar që të me ktheni përgjigje lidhur me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë përmes Sekretarit të Përgjithshme të saj për produkte orfane. Ju ka shkruar edhe dje në mëngjes dhe po bëhet sot me datë 10.10.2023 katër ditë që ju nuk keni gjetur kohë të ktheheni përgjigje në çështjen ku bëhet fjalë për produkte të sëmundjeve të rralla. Duke u nisur nga fakti se jeni Drejtor i DAM-së për vite të tëra, moskthimin e përgjigjes për një temë që lidhet kryekëput me kompetencat e departamentit që ju drejtoni konsideroj neglizhencë dhe mos përmbushje të detyrave të dhëna.*
- *Po ashtu me datën 19 Shtator 2023 kam kërkuar nga ana e juaj të ofroni sqarimin profesional të kërkuar nga SHKCUK se a përputhet përqindja me dozën apo është lëshuar gabim teknik lidhur me produktin trade name: Calciumgluconat 10 % me Pharmaceutal form strength: solutaion for injection 10mg/ml. Ju jo vetëm që nuk keni ofruar sqarimin e kërkuar, por keni nxjerrë jashtë AKPM-së dokumente që me Ligjin e Produkteve dhe Pajisjeve*



*Medicionale dhe UA për Autorizim Marketingu, AKPMM obligohet të ruaj konfidencialitetin e dokumenteve të dorëzuar nga aplikasi.*

- *Po ashtu ju kam tërhequr vërejtjen disa herë si mbikëqyrës i drejtpërdrejt që të evidentohen me foto në aparatit e vijueshmërisë në punë dhe të mbikëqyrni vijueshmërinë e vartësve tuaj në punë dhe keqpërdorimin e karteleve të njeri tjetrit me rastin e evidentimit në aparatit e SMVP-së.*
- *Po ashtu vlerësoj së nuk keni aspak fokus në evitimin e pritjeve me rastin e ofrimit të shërbimeve në DAM dhe mbarëvajtjes së punëve në këtë departament.*

Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me Vendimin me Nr.Prot.3959 të datës 06.11.2023, ka gjetur se ankuesi është përgjegjës për të gjitha shkeljet e përcaktuara sikurse në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore gjegjësisht ka konstatuar si i njëjti ka bërë shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.4, 4.5, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 16 të Ligjit N.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe nenit 16 dhe 17 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 për Autorizim Marketingu, duke i shqiptuar masën disiplinore "Largimi nga shërbimi civil".

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se: nxjerrja e vendimit të kundërshtuar me ankesë është i përfshirë me shkelje të rënda ligjore të dispozitave të procedurës, me arsyetimin se inicimi i procedurës disiplinore është në in -kompetencë është bërë nga personi që në kundërshtim e ushtron detyrën e zyrtarit kryesor administrativ, se shqyrtimi i provave nga ana e komisionit disiplinor sa ka qenë në pushim mjekësor, përkatësisht pa praninë e të njëjtit duke i'a mohuar të drejtën për të dëgjuar si një parim i normuar kushtetues ka qenë diskriminues ndaj të njëjtit dhe shkelje e ligjit aktual në fuqi. Tutje shton se lidhur me kthimin e përgjigjes për çështje ku bëhej fjalë për produkte që lidhen me sëmundje të rralla, i njëjti nuk ka pasur afat të caktuar procedural a imperativ lidhur me kthimin e përgjigjes dhe se ky rast nuk ka qenë fare i ndërlidhur me një procedurë administrative të përcaktuar në mandatin e agjencisë dhe të DAM-së apo të tij si drejtor, prej nga deklaroi se ka kthyer përgjigjen me datë 16.10.2023 saktësisht 4 ditë pas pranimit të kërkesës në mënyrë elektronike. Lidhur me pretendimin se i njëjti ka nxjerrë dokumente jashtë AKPPM-së e të cilat konsiderohen konfidenciale, ka deklaruar se për këtë çështje ka ofruar përgjigje për SSHKUK-në dhe kjo mund të vërtetohet, ngase konfidencialiteti i dokumenteve që i detyrohet AKPPM palëve ka theksuar se ka të bëjë me ruajtjen e dokumentacionit për palët e pa autorizuar, në këtë rast SSHKUK-ja e që nuk është palë komerciale e as palë e autorizuar, andaj nuk qëndron fare pretendimi se i njëjti ka nxjerrë material konfidencial përtej asaj çfarë parashikojnë ligjet në fuqi. Lidhur me pjesën e vijueshmërisë në punë e që lidhet me përgjegjësinë disiplinore, i njëjti ka theksuar që komisioni e ka mbajtur përgjegjës për mos evidentimin me foto në aparatit e vijueshmërisë në punë, si dhe mos mbikëqyrje të vartësve që punojnë në DAM, ka theksuar që se ky pretendim është i pa bazuar dhe tendencioz ngase ka mund të ndodh që nuk janë regjistruar me kohë, por që mund të ketë ndodhur në raste të jashtëzakonshme por se shpesh kanë qëndruar në punë edhe pas orarit dhe se për këtë pjesë asnjëherë nuk ka marrë vërejtje as nga mbikëqyrësi e as nga askush për një gjë të tillë, e cila ka ndodhur gjerësisht nga shumë prej nëpunësve të AKPPM-së. Sa i përket përgjegjësisë lidhur me evidentimet të cilat janë gjetur në raportin e auditorit të brendshëm nga ana e tij, thekson se të gjeturat që kanë ndërlidhje direkte me përgjegjësitë e tij funksionale si drejtor ose janë jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tija ose janë pa kurrfarë dëmi e as peshë në raport me çfarëdo përgjegjësie disiplinore. Ne petitem të



ankesës kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë për emërimin e zv. Kryeshefit Ekzekutiv të AKPPM-së, vendimi me numër protokoll 3959 i datës 06.11.2023 i Komisionit Disiplinor, si dhe të obligohet Zyrtari kryesor administrativ i AKPPM-së përkatësisht Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që në afatin prej 15 ditësh për zbatim të vendimit duke e kthyer të njëjtin në vendin e punës si Drejtor i Departamentit për Autorizim Marketingu.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i'u referua dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton se ankesa është e pranueshme, ngase ankuesi ka legjitimitetin e palës për të ushtruar ankesë dhe se ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin e se njëjtës siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit me datë 26.01.2024, ka mbajtur seancë dëgjimore, ku në cilësi të palëve në procedurë janë ftuar: ankuesi në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Autorizim Marketingut në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv të AKPP-së si dhe anëtarët e Komisionit Disiplinor në pozitën Udhëheqës i Zyrës Ligjore, Zyrtar i Lartë i Licencimit si dhe ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit të Administratës për Buxhet dhe Financa.

Ankuesi në seancën dëgjimore si dhe në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kolegjit ka deklaruar se: *"Ju falënderoj për dhënien e mundësisë lidhur me këtë seancë publike. Meqenëse unë nuk kam pasur rastin të deklarohej në komision disiplinor, kam konsideruar si të nevojshme që të mbahet seancë në Këshill, në mënyrë që të paraqes prova lidhur me çështjen. Lidhur me pikën e parë për mos kthimin e përgjigjes së për emailin e datës 06.10.2023, sipas kërkesës drejtuar atij nga dhe po atë ditë kërkesën e kam përcjellë tek zyrtarja e cila është Udhëheqëse e Divizionit pranë DAM-së, e cila njëkohësisht është anëtare e nën komisionit për produktet orfane dhe në CC ka qenë i njoftuar edhe kryeshefi. Kërkesa i është përcjellë zyrtares në fjalë, për arsye se bazuar në ligjin për produktet medicinale orfane ky nën komision është përgjegjës për përcaktimin e listës së produkteve medicinale orfane dhe kam marrë përgjigje nga ajo me dt.10.10.2023 ku e keni edhe e-mailin prej nga edhe ajo vet kërkon se jam duke pritur përgjigje nga zyra ligjore e MSH-së dhe sapo kam marrë përgjigje nga ajo, unë e kam delegua tek Kryeshefi dhe pastaj me dt.16.10.2023 pas kërkesës së kryeshefit e kam përcjellur sqarimin lidhur me listën e barnave orfane. Unë nuk e di çfarë pasojashi kanë muajt me pas, ngase ka qenë afati nga dt.06.10.2023 deri më 16.10.2023, por nuk kemi mujt me kthe përgjigje deri sa nuk kemi pas përgjigje nga zyra ligjore e MSH-së. AKPM-ja nuk merret me furnizime të barnave, mirëpo merret MSH-ja dhe SSHKUK-ja, ndërsa përgjegjësi e AKPM-së është vendosja e barit në treg, lëshimi i autorizimit. Çdo AM nënshkruhet nga kryeshefi ekzekutiv dhe ai ka të drejtë të aprovoj apo refuzoj. Sa i përket pjesës së dytë të shkeljes disiplinore është nxjerrja e dokumentit konfidencial nga AKPM-ja dhe*



mos kthimi i përgjigjes konkrete ndaj palës nga ana ime për ta, ndërsa dëshmia thotë diçka tjetër. Në emailin të cilin e kam pranuar nga të cilit i është drejtua kam kthyer përgjigje në të njëjtën ditë, ndërsa meqenëse nuk është ekspert i lënusë farmaceutike, i njëjti konsideron që CPP-ja nuk është dokument konfidencial, rrjedhimisht nuk është shkelje sepse i është dërguar një organi të brendshëm të SHKSUK-së". CPP-ja nënkupton se pasaportën e produktit medicinal me të gjitha të dhënat e produktit farmaceutik, që përfshinë emrin e produktit farmaceutik, fortësinë e tij, lëndën vepruese, emrin e prodhuesit, të dhënat se a është në tregun e vendit të origjinës apo jo, etj". Meqenëse kërkesa ka qenë brenda institucionit të MSH-së kam vlerësuar se nuk është konfidenciale dhe duke ditur faktin se me rastin e shpalljes së tenderëve nga SHSKUK-ja e ofrojnë çdo herë kompanitë tenderuese si dokument me rastin e aplikimit. Sa i përket pikës së tretë të shkeljes disiplinore e që është për videoincizimet në SMVP-ja. Mbetet pranë pretendimeve sikurse në ankesën e datës 06.12.2023 të parashtruar në Këshill.

Iniciuesi i procedurës disiplinore, në këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv i AKPMM-së, në seancën dëgjimore si dhe në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kolegjit ka deklaruar se: "Nga vet pyetja që e lexuat, këto çka i tha ankuesi nuk kanë të bëjnë me nën komisionin e produkteve orfane, pyetja ka të bëjë drejtpërdrejtë me detyrat e DAM-së, sepse pyetja ka qenë e drejtuar agjencisë lidhur me kthimin e përgjigjes nga ankuesi se pse është lëshuar autorizim marketingu për disa produkte orfane kur ligji shprehimisht i përjashton nga ligji, dhe se pyetja ka qenë e rëndësisë së veçantë ngase mos përgjigja e drejtorit ka shpirtë në 6 milion euro suficit, ku edhe sot e kësaj dite janë disa produkte që nuk është dasht me u lëshuar autorizimi i marketingut, ngase ligji këto produkte i ka përjashtuar nga ky autorizim, rrjedhimisht në mungesë të përgjigjes janë stopuar veprimet për iniciim të kërkesës lidhur me furnizim të barnave për pacientët me sëmundje të rënda dhe të rralla. Nuk ka kthyer përgjigje ankuesi deri me datën e inicimit të procedurës disiplinore. Nën komisioni është përgjegjës për përgatitjen e listës shtetërore të barnave orfane bazuar në kërkesat e SSHKUK-së, ndërsa DMA-ja është përgjegjës vetëm për lëshimin e autorizimeve të marketingut për produktet medicinale, çka nënkupton se funksionet janë të ndryshme. Po ekziston dëshmia nga nën komisioni lidhur me identifikimin e 7 barnave e për të cilat është lëshuar AM-ja e të cilat nuk kanë mundur të përfshihen në listën shtetërore të barnave. Thekson se DAM-ja e bënë vlerësimin e aplikimit të produktit medicinal përkatës të caktuar dhe pasi që përgatitet vlerësimi dhe bëhet aprovimi nga vlerësuesi fillimisht, pastaj shkon tek drejtori i departamentit të AM-së i cili është kompetent për vlerësimin dhe ai mban përgjegjësinë e miratimit ose refuzimit dhe pas kësaj i njëjti përcillet tek kryeshefi, i cili ka përgjegjësinë vetëm për veprimin formal të nënshkrimit të certifikatës të AM-së, sepse kryeshefi nuk ka asnjë autorizim që ta shqyrtoj vlerësimin nga zyrtarët përgjegjës, gjegjësisht departamenti përkatës. Nuk pajtohem, të njëjtën përgjigje nga ankuesi e kam përcjell tek Sekretari i MSH-së. Bazuar në ligjin për produktet dhe pajisje medicinale nenin 16 si dhe neni 19 i Udhëzimit administrativ për autorizim marketingu ku thuhet se i gjithë dokumentacioni është konfidencial i dosjes së autorizim marketingu përveç fletë udhëzuesve, në këtë rast i njëjti ka bërë dy shkelje dmth mos kthim i përgjigjes adekuate profesionale në kërkesën e SSHKUK-së dhe nën 2 shkelja tjetër është dërgimi i dokumentit konfidencial CPP-së siç e specifikova që është dokument konfidencial sipas ligjit dhe udhëzimit dhe që përbënë shkelje të rëndë disiplinore sipas ligjit në fuqi. Unë kam filluar punën si U.D i Kryeshefit në tetor të vitit 2022 dhe nuk kam bërë vlerësim për ankuesin, ndërsa për vitin 2023 skam bërë vlerësim pasi që i njëjti është larguar nga shërbimi civil. Në mënyrë të vazhdueshme



keni tërhequr vërejtjen për respektim të orarit të punës, veçmas nga menaxheri i personelit ndërsa unë edhe vet në shtator kam bërë verifikimin e kamerave nga dhe kam vërejtur mos respektim të orarit gjegjësisht mos fotografim me rastin e klikimit ku me dt.26.09.2023, kam dërguar e-mail zyrtare disa herë gjatë vitit, I gjithë stafi tjetër kanë kontribuar në këtë proces, ndërsa drejtori nuk ka dhënë kontribut fare në këtë proces në mungesë të stafit në këtë departament...”

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm nga data 26.09.2023) që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: “Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.
- Nenit 66, paragrafi 1 dhe 4 me të cilin është përcaktuar se: “ Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1.mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.
- Nenit 57 paragrafi 2 : “ Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.
- Nenit 58, paragrafi 2 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore: “Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor”.



Referuar kuadrit ligjor si me sipër, e në mbështetje të nenit 86 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje administrative si dhe deklaratave të palëve në procedurë dhe si rrjedhojë konstatoi se Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale ka vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë përgjegjësisë disiplinore të ankuesit, për arsye se:

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ishte ftuar për në seancë dëgjimore pranë Komisionit Disiplinor me datë 31.10.2023, mirëpo, i njëjti në datën kur ishte planifikuar të mbahej seanca dëgjimore ishte në punë dhe se përmes emailit zyrtar, në orën 08:41 ka njoftuar Kryeshefin Ekzekutiv dhe Njësinë e Burimeve Njerëzore, se për shkaqe shëndetësore nuk do të jetë në punë. Ndërsa, bazuar në dëshmitë mjekësore të bashkangjitura në ankesën e parashtruar në Këshill, rezulton se ankuesi kishte qenë në pushim mjekësor nga data 31.10.2023 deri me datë 03.11.2023 si dhe nga data 06.11.2023 deri 13.11.2023. Përkundër këtyre rrethanave i njëjti nuk kishte ndërmarr asnjë veprim në drejtim të informimit të Komisionit Disiplinor për mos pjesëmarrje në seancën e datës 31.10.2023, apo te kishte kërkuar shtyrjen ose caktimin e një seance tjetër për prezantimin e fakteve nga ana e tij. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve, Kolegji konstaton se nuk ka mbështetje pretendimi ankimor i ankuesit se të njëjtit i është mohuar e drejta për tu dëgjuar në procedurë disiplinore.

Lidhur me shkeljen disiplinore të ankuesit për mosdhënie të përgjigjes përkritazi me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrish së Shëndetësisë, Kolegji i Këshillit bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës ka gjetur se më datë 06.10.2023, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), ka parashtruar kërkesë të Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së me përmbajtje se: *A mund të na njoftoni se pse janë lëshuar AM për këto produkte, kur ligji shprehimisht i përjashton ato nga AM, dhe po në të njëjtën datë Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së ka kërkuar nga ana e ankuesit në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Autorizim Marketingut, të ofroj përgjigje lidhur me kërkesën në fjalë. Me tej, sipas provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë rrjedhë së ankuesi po me datë 06.10.2023, kërkon nga nëpunësja civile si vartëse dhe njëkohësisht si anëtare e nen komisionit për produkte orfane, që të ndihmoj më përgjigje lidhur me kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv. Në mungesë të përgjigjes nga ankuesi lidhur me kërkesën e datës 06.10.2023, Kryeshefi Ekzekutiv përsëri më datë 09.10.2023 kërkon nga ana e ankuesit që është në pritje të përgjigjes nga ana e tij, rrejdhimisht sipas komunikimeve elektronike në mes të ankuesit dhe Kryeshefit Ekzekutiv rezulton se edhe pas inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit me datë 10.10.2023, Kryeshefi Ekzekutiv serish me 13.10.2023 kërkon nga ankuesi që të jap sqarim në pyetjen e parashtruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së. Kurse, ankuesi më datë 16.10.2023 ka ofruar sqarim lidhur me kërkesën në fjalë, pra dhjetë ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës.*

Në kontekst të përgjegjësisë së ankuesit për ofrim të sqarimeve lidhur me kërkesën e datës 06.10.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së, Kolegji analizoj përshkrimin e detyrave të Drejtorit të Departamenti për Autorizim Marketingu, pozitë të cilën ankuesi e ushtron ku citojmë: *të kryej të gjitha aktivitetet udhëheqëse lidhur me Departamentin e Autorizim Marketingut në AKPPM, si dhe ti caktoj objektivat/planin strategjik për Departamentin të cilat i kontribuojnë objektiveve të AKPPM-së; Mbajta e kontakteve me nivelet e larta brenda dhe jashtë Shërbimeve Civile që të shkëmbej informata dhe përfaqësoj qëndrimet e Departamentit/AKPPM-së rreth*



*çështjeve relevante; Kontrakton dhe korrespondon me agjencionet tjera referente për produktet medicinale, Kordinon punën rreth licencimit dhe regjistrimit të barnave sipas procedurave strikte ligjore, Merret me një shumëllojshmëri të kontakteve brenda dhe jashtë AKPPM-së; Në mënyrë të vazhdueshme informon zyrën e licencimit të importit lidhur me statusin e produkteve medicinale, në mënyrë që të bëhet kontrolli i importit të autorizuar të produkteve medicinale; Vlerësimin e dokumentacioneve të dorëzuar për licencimin e barnave; Vlerësimin e dokumentacioneve të dorëzuar për licencimin e branave; Zhvillimin dhe implementimin e procedurës së licencimit dhe regjistrimit të plotë të barnave në harmonizim me ligjet e Republikës së Kosovës, ndërsa për rastet të cilat nuk janë rregulluar me legjislacionin vendor, do kërkoj aprovim nga Kryeshefi Ekzekutiv për t'ju referuar të BE-së....etj. Andaj, nisur nga ky përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorit të DAM-së, Kolegji vlerëson së kërkesa e Sekretarit të Përgjithshëm të MSH e datës 06.10.2023, i referohej sqarimit lidhur me lëshimin e autorizimeve të marketingut për barnat orfane (sëmundje të rralla), pra, kërkesa atakon në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjësitë e ankuesit dhe së kërkesa në fjalë ishte parashtruar me prioritet të lart të trajtimit ( high importance). Si rrjedhojë, mbi bazën e këtyre fakteve dhe rrethanave, Kolegji konstaton së ankuesi ka qenë përgjegjës që të ofroj sqarimet e kërkuara sikurse në kërkesën e datës 06.10.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së dhe së të njëjtën kërkesë duhet ta trajtonte në periudhë sa me të arsyeshme kohore, nisur nga fakti se kërkesa ishte dërguar si çështje me prioritet të rëndësishme të lartë dhe se edhe vet Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së kishte kërkuar që përgjigja nga ankuesi të jetë sa me shpejt që është e mundur, kështu që veprimet/mosveprimet e ankuesit si në rastin konkret cilësohen si shkelje disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1, 3.2 dhe 3.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.*

Kolegji i Këshillit si fakt relevant lidhur me konstatimin si me lartë, mori parasysh interpretimin ligjor të Departamentit Ligjor të MSH-së, të datës 13.10.2023, me të cilin është konfirmuar se sqarimet lidhur me barnat e regjistruara e që kanë certifikatë të Autorizim Marketingut dhe që janë larguar nga lista shtetërore e produkteve bonjake, bie në kompetencë të Departamentit të Autorizim Marketingut në AKPPM-së.

Ndërlidhur me shkeljen disiplinore të ankuesit referuar mos ofrimit të sqarimit profesional lidhur me kërkesën e SHSKUK-së të datës 29.09.2023, Kolegji nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se Shefi i Prokurimit të SHSKUK, me data 29.09.2023 kishte kërkuar sqarime me përmbajtje se: *"Lidhur me një aktivitet të prokurimit kemi hasur paqartësi të AM me numër serik MA No:MA-0308/29/12/2021 i lëshuar nga AKPM për produktin: Product trade name: Calciumgluconat 10% B. Braun me Pharmaceutical form &Strength: solution for injection 10 mg/ml (të cilin e keni të bashkëlidhur në këtë e-mail) kërkojmë të na sqaroni Product trade name Calciumgluconat 10% me Pharmaceutical form&Strength: solution for injection 10 mg/ml a përputhen (përqindja me dozën) apo është ndonjë gabim teknik",* rrjedhimisht, po më datë 29.09.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së, ka kërkuar nga ana e ankuesit që të kthej përgjigje në kërkesën e datës 29.09.2023, ndërsa, ankuesi po në të njëjtën datë ka kthyer përgjigje me sqarimin se, citoj: *"Certifikata e dërguar e AM-së nga SHKSUK është aprovuar konform CPP-së së aplikuar nga pala (gjej bashkangjitur).* Tutje, Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së me datë 02.10.2023, serish kërkon nga ankuesi që të ofroj përgjigje sipas kërkesës së SHKSUK-së, sepse pyetja e parashtruar nga kjo e fundit, nuk ka të bëjë me Autorizim Marketingun konform CPP-së, por se a përputhet përqindja me dozën apo është lëshuar ndonjë gabim teknik, kurse, sipas provave të çështjes të prezantuar nga ankuesi si në ankesë dhe në seancë dëgjimore të datës 26.01.2024,



nuk vërtetohet fakti se ankuesi ka dhënë ndonjë përgjigje sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i tij dhe në cilësinë e Zyrtarit me të Lartë Administrativ. Kështu që, mbi bazën e ekzistimit të këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson se veprimet e ankuesit bien ndesh me nenin 29 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *Zyrtarja/i publik ka për detyrim të veprojë në përputhje me urdhrin e marrë nga mbikëqyrësja/i apo zyrtarja/i tjetër me kompetenca kontrolli ndaj saj/tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të brendshme të institucionit.*

Përkitazi me shkeljen disiplinore referuar mos respektimit të orarit të punës, procedurave të regjistrimit të vijueshmërisë në punë si dhe keqpërdorimit të kartelave të regjistrimit në punë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se regjistrimi i stafit në AKPPM bëhet përmes sistemit elektronik i cili administrohet nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Drejtori i Departamentit të Financave dhe Shërbime të Përbashkëta të AKPPM-së gjatë vitit 2023, disa herë radhazi si me datë 06 shkurt 2023, 01 mars 2023, 30 qershor 2023, 4 dhe 7 gusht 2023, 22 dhe 26 shtator 2023, ka kërkuar nga të gjithë drejtorët e AKPPM-së që të respektohet vijueshmëria në punës si dhe regjistrimi në sistemin e vijueshmërisë në punë të jetë i shoqëruar edhe me foto, pasi që ka zyrtarë të cilët nuk evidentohen me foto. Po ashtu, kërkesa të ngjashme ishin parashtruar edhe nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së.

Rtjedhimisht, për vendosje të drejtë, Këshilli më datë 27.01.2024 ka kërkuar sqarim nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit lidhur me faktin se me rastin e regjistrimit të hyrjeve/daljeve nga puna në sistemin e vijueshmërisë në punë, zyrtarët publikë a janë të obliguar që të bëjnë edhe regjistrimin e fytyrës në aparat (pra me foto), ndërsa, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit sipas përgjigjes së datës 30.01.2023 dhënë për Kwshillin ka konfirmuar se: *“Lidhur me kërkesën tuaj, ju njoftoj Sistemi i Vijueshmërisë në Punë (SVP) funksionon në atë mënyrë që aktivitetet/ngjarjet (hyrje në punë, dalje nga puna, dalje në pauzë a teren, etj.) e realizuara në pajisje/terminale të vendosura në hyrje të ndërtesave të institucioneve, e të cilat menaxhohen e administrohen nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, me rastin e realizimit të aktivitetit/ngjarjes, terminali realizon edhe fotografimin e zyrtarit. Pra çdo aktivitet i realizuar nga ana e zyrtarëve në këto terminale, në atë moment realizohet edhe fotografimi i ti dhe e njëjta përcillet në sistem, gjë që pastaj zyrtarët përgjegjës të institucionit përkatës mund të verifikojnë nëse zyrtari përkatës ka realizuar vet ose jo aktivitetin/ngjarjen”.*

Me tepër, Kolegji i Këshillit nga analizimi i evidencave të vijueshmërisë në punë lidhur me ankuesin ka gjetur se regjistrimet përmes kartelës së ankuesit me datë 14.03.2023, 24.04.2023, 21.06.2023, 22.09.2023, janë bërë nga dikush tjetër, ndërsa, lidhur me datën 12.01.2023, 31.01.2023, 09.02.2023, 13.02.2023, 15.02.2023, 20.02.2023, 28.02.2023, 02.03.2023, 09.03.2023, 20.03.2023, 27.03.2023, 05.04.2023, 14.04.2023, 28.04.2023, 16.05.2023, 31.05.2023, 16.06.2023, regjistrimet në aparatit e vijueshmërisë janë bërë pa fotografi të përdoruesit.

Me qëllim të identifikimit të personave të cilët kanë bërë regjistrimet në punë përmes kartelës së ankuesit, Kryesuesja e Kolegjit në seancën dëgjimore të datës 26.01.2024, ka prezantuar para ankuesit fotot e regjistrimit të vijueshmërisë në punë të datave 24.04.2023, 14.03.2023, 28.02.2023 dhe 09.02.2023, duke kërkuar nga ankuesi identifikimin e personave në foto, ndërsa,



i njëjti ka konfirmuar së njëra është bashkëshortja e tij e cila nuk është pjesë e stafit të AKPPM-së, kurse, të tjerët persona janë kolege të tij të punës.

Referuar konstatimit si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor i AKPPM-së me të drejtë ka vendosur përgjegjës ankuesin për mos respektim të vijueshmërisë në punë, mos respektim të procedurave të regjistrimit përmes fotos si dhe regjistrim me kartelë të ankuesit nga persona dhe zyrtarë tjerë, kështu që, këto veprime të ankuesit paraqesin shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.13 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me shkeljen disiplinore për mosrespektim të afateve për vlerësim të dokumentacionit që ka rezultuar me vonesa të lëshimit të AM-ve, Kolegji bazuar në Raportin e Auditorit të Brendshëm të datës 20.09.2023, (mbi bazën e të cilit Komisioni Disiplinor ka konstatuar shkeljen) ka gjetur se ky auditimi i brendshëm ka përfshirë procedurat e lëshimit të Autorizim Marketingut për vitin 2022 si dhe shtatë mujorin e vitit 2023, mirëpo, nga analizimi i provave të lëndës Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të argumentoj drejtë dhe në mënyrë të plotë përgjegjësinë e ankuesit lidhur me këtë shkelje, sepse, në vendimin e kontestuar është dhënë vetëm konstatim i përgjithësuar i shkeljes, duke mos specifikuar saktë rastet kur janë gjetur vonesat, cilës periudhë i referohen dhe numrin e rasteve të vonuara. Rrejdhimisht, është fakt i pa kontestuar se Raporti i Auditimit të Brendshëm i datës 20.09.202, ka evidentuar mos respektim të afateve nga ana e zyrtareve përgjegjës për vlerësimin e dokumentacionit për lëshimin e Autorizim Marketingut, mirëpo, Komisioni Disiplinor fare nuk kishte marr parasysh faktet relevante, gjegjësisht, faktin se Raporti i Auditimit të Brendshëm i datës 20.09.2023 ka evidentuar mungesë të resurseve njerëzore në Departamentin e Autorizim Marketingut, duke rekomanduar njëkohësisht edhe plotësimin e kësaj njësie me zyrtarë të njafueshëm si dhe faktin se gjatë periudhës 02.02.2023 deri 02.08.2023 nuk ka qenë duke e ushtruar pozitën e Drejtorit të DAM-së, ngase i njëjti ishte transferuar përkohësisht në një pozitë tjetër në kuadër të AKPPM-s sipas Vendimit Nr.46/II/2023 të datës 02.02.2023, e për të cilën periudhë ankuesit nuk mund ti vihet në barrë përgjegjësia lidhur me lëshimin e AM-ve. Gjegjësisht, këto fakte janë konfirmuar edhe nga vet Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së në seancën dëgjimore të datës 26.10.2023 pranë Këshillit. Andaj, nisur nga ekzistimi i këtyre rrethanave, e në mbështetje të dispozitave të nenit 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilat është përcaktuar se: *3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar*, arsyetimi i dhënë sipas këtij vendimi zëvendëson arsyetimin e dhënë në Vendimin Nr.667/XI/2023, të datës 06.11.2023 të Komisionit Disiplinor lidhur me shkeljen disiplinore sa i përket pikës së IV, ndërsa, mbetet i pandryshuar arsyetimi i vendimit të kontestuar referuar shkeljeve tjera disiplinore, shkelje këto të konstatuara sipas këtij vendimi të Këshillit, e të cilat e bëjnë të ligjshëm dispozitivin e Vendimit Nr.667/XI/2023 të datës 06.11.2023 të Komisionit Disiplinor të AKPPM-së.

Përmbledhur si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.




**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 1482/2023

Ardita Perçiku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhinikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.